

FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

E ENJTE 21 KORRIK 2022

E nderuar Kryetare,

dua t'i bashkohem koleges Tabaku në nevojën që ka ky parlament për të diskutuar për një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme, siç është anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin European, për faktin se ky proces nuk është vetëm proces i qeverisë, por është procesi i gjithë politikës dhe i shoqërisë shqiptare dhe konsensusi për këtë proces është realizuar pikërisht në këtë Kuvend, me përgjegjshmëri politike në të gjitha këto vite. Prandaj do të ishte e nevojshme që para muajit shtator, kur mblidhet përsëri Kuvendi, të kishim një diskutim serioz për sa i përket këtij procesi. E them këtë, sepse e vlerësoj atë çka ndodhi para disa ditësh si një moment të jashtëzakonshëm, me rëndësi historike për Shqipërinë.

E kemi filluar në vitin 1990 me dëshirën dhe thirrjen "Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa!", kundër regjimit komunist, kemi punuar pa reshtur, me mirëkuptim dhe kuptim për sa i përket nevojës për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin European, që në hapat e parë në raportet me Bashkimin European, hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, miratimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, më tej liberalizimin e vizave, kërkesën për hapjen e negociatave, gjithmonë duke menduar se kjo i tejkalon partitë politike. Sot nuk ka nevojë as për triumf dhe as për ndarje, por ka nevojë për bashkim të politikës dhe të të gjithë shqiptarëve, që të bëjmë të mundur që Shqipëria të jetë pjesë e Bashkimit European sa më shpejt, për të realizuar një qëllim dhe një ëndërr të të gjithë shqiptarëve.

Për më tepër, ka nevojë ne, si Kuvend, të punojmë për të garantuar zgjedhje të lira dhe të ndershme, të kërkojmë luftë kundër korrupsionit, kundër krimit të organizuar, forcimin e institucioneve demokratike, demokracinë shqiptare, respektimin e Kushtetutës si rruga e vetme që ne mund të bëjmë të gjithë së bashku për ta bërë Shqipërinë pjesë të Bashkimit European. Prandaj, edhe një herë, zonja Kryetare, mendoj se ndoshta është e nevojshme të kemi një seancë për të diskutuar për këtë çështje, për angazhimin që duhet të ketë parlamenti shqiptar

për të ecur së bashku dhe për të mbajtur qeverinë përgjegjëse për të realizuar detyrimet e veta, se pas 10 vjetësh ne arritëm të hapnim negociatat për t'u bërë pjesë e Bashkimit European, të cilat mund të zgjasin, nëse ne do të ndahemi, por mund t'i realizojmë më shpejt nëse do të dimë të punojmë me përgjegjshmëri, duke vënë interesin kombëtar mbi çdo interes politik. Faleminderit!